



Datë: 02.10.2025
Numër Protokolli: 6553/2025

A.nr. 1590/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj–Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari- anëtarë, me Rushit Kajtazi- në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr. 1590/2025, të datës 12.08.2025, të parashtruar nga ankuesi Sh.P, kundër organit të punësimit: Sekretariati i Këshilli Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën A.nr.1590/2025, e datës 12.08.2025, e parashtruar nga ankuesi Sh.P.

A r s y e t i m

Ankuesi Sh.P (me tej referuar vetëm ankuesi), më datë 12.08.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.1590/2025, lidhur konkursin me numër protokolli Nr. 01/2025, të datës 05.02.2025, të shpallur nga Sekretari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për pozitën Udhëheqës i Zyrës për Mbështetje Juridike, në Gjykatën Themelore në Ferizaj.

Kolegji i Këshillit, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit Sh.P, është bërë i pamundur sepse:

Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se ankuesi Sh.P, ankesën me numër protokolli 5432/2025 të datës 12.08.2025, e ka parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa kërkesën për tërheqje e ankesës e ka parashtruar me datën 09.09.2025 me numër protokolli 6040/2025, në Këshillin e Pavarur mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Prandaj Kolegji i Këshillit ka konstatuar se procedimi administrativ i iniciuar më ankesë është bërë i pamundur.

Ndërlidhur me tërheqjeje e ankesës nga ankuesi. Kolegji i Këshillit, pas tërheqjes së ankesës nga ana e ankuesit konstaton se kërkesa për tërheqje të ankesës është e drejtë e ankuesit e përcaktuar me dispozitat nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"*, andaj bazuar në këtë veprim administrativ të ankuesit, konstatohet se është përmbushur kushti ligjor për të vendosur për përfundim të procedimit administrativ të iniciuar sipas ankesës me numër protokolli 5432/2025 e parashtruar nga ankuesi Sh.P.

Kolegji i Këshillit, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendimin hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1590/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, Sh.P;
- Divizionit për Burime Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së